

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar në Kreun V të Ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Garda e Republikës shpall procedurat e aplikimit për:

- 1 vend të lirë për punonjës në funksione të vaçanta, **Mjek në Sektorin e shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Gardën e Republikës.**

I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR PUNONJËS TË NIVELIT TË MESËM DHE BAZË:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të mos jetë i përjashtuar nga institucionet e administratës shtetërore, të institucioneve ligjzbatuese dhe të mos jetë larguar nga shërbimi civil;
- c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për të kryer detyrën;
- d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë përkatës;
- dh) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një prej kriterëve të mësipërme, nuk kualifikohet dhe nuk mund të vazhdojë konkurrimin.

II. DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT:

Kandidatët që aplikojnë për punonjës në funksione të vaçanta, **Mjek në Sektorin e shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Gardën e Republikës**, duhet të paraqesin në fazën e parë të konkurrimin dokumentet e mëposhtëm:

- a) Kërkesë
- b) CV (Kurikulum vitae)
- c) Kopje të kartës së identitetit
- d) Dëftesën e shkollës së mesme ose listë notash, të cikluar në Drejtorinë Arsimore të Rrethit, të fotokopjuar dhe të noterizuar si dhe Diplomën e arsimit të lartë me listë notash, të fotokopjuar dhe të noterizuar.
- e) Vërtetim nga Gjykata.
- f) Vërtetim nga Prokuroria.
- g) Raport i aftësisë në punë (sipas shtojcës V, të VKM nr.596, datë 4.9.2019), nga mjeku i familjes.
- h) Dy foto (9 X 12) me kostum dhe kollare.
- i) Vërtetim ose librezë pune që vërteton përvojën e punës në fushën përkatëse.

Dokumentet dorëzohen në adresën: “Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, pranë Pallatit të Brigadave, Tiranë, me postë ose duke u paraqitur personalisht në ambientet e Gardës.

Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumenteve është **brenda datës 23.09.2026.**

III. SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIMIT

Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 1 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit. Kandidati që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet dhe do të njoftohet individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail ose me telefon).

Kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Komisioni i Apelit shqyrton ankesat dhe kthen përgjigje brenda 2 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

IV. TESTIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët që konkurrojnë për funksionin **Mjek në Sektorin e shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Gardën e Republikës**, e kualifikuar në fazën e dorëzimit dhe kontrollit të dokumenteve, duhet të paraqiten **në orën 08:00 të datës 28.09.2026**, në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, pranë Pallatit të Brigadave, Tiranë, për t'iu nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës. Kandidati që nuk paraqitet për testim, skualifikohet.

V. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Për vlerësimin e kandidatëve përdoret sistemi me 100 pikë, i cili përbëhet nga këta komponentë:

- | | |
|---------------------|---------|
| • Testimi me shkrim | 70 pikë |
| • Intervista | 30 pikë |

Aplikanti skualifikohet kur nuk arrin të marrë të paktën 40 pikë të testimit me shkrim. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas rendit zbritës të pikëve, nga rezultati më i lartë në atë më të ulët.

VI. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË KONKURRIMIT

Në përfundim të të gjithë procedurës së konkurrimit dhe vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues, do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës.